



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 211, Datë 18.12.2019**

**MBI**

**SHTYRJEN E PERIUDHËS TRANZITORE PËR BËRJEN EFEKTIVE TË  
TRANSFERIMIT TË LICENCAVE TË OPERIMIT TË SISTEMIT TË  
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I  
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A. (OSHEE SH.A.), TEK  
SHOQËRIA "OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES" SH.A. (O.S.SH SH.A.);  
LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE DETYRIMIT TË  
SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË  
SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.  
(OSHEE SH.A.), TEK SHOQËRIA "FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL" SH.A.  
(FSHU SH.A)".**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërmat “c”, “ç”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neni 113, pika 3 të Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 118 Prot, datë 13.12.2019, mbi shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të shoqërisë operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a.),

**Konstatoi se:**

Bordi i ERE me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi:

- 1. Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muaj, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a); miratuar me vendimin e bordit të ERE-s. Nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Furnizuesi i*

*Shërbimit Universal“ sh.a. (FSHU sh.a.) miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 215, datë 11.10.2018.*

2. *Deri në përfundimin e periudhës tranzitore prej 12 muaj, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a..*
- Në lidhje me këtë vendimmarrje, ERE ka vijuar komunikimet me OSHEE sh.a. për të marrë informacion mbi këtë proces dhe së fundmi i është drejtuar me shkresën nr.719 Prot, datë 07.11.2019, me anë të së cilës i është kërkuar informacion mbi ecurinë e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a..
- OSHEE sh.a. i është përgjigjur me shkresën nr. 23524/1 Prot, datë 03.12.2019, protokolluar në ERE me nr.719/1, datë 06.12.2019, nëpërmjet të cilës i kërkon ERE shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, duke sqaruar se :
  - në vijim të punës përgatitore të OSHEE sh.a. për procesin e ndarjes së shoqërisë, si dhe në kuadër të orientimeve, takimeve, diskutimeve të zhvilluara në zbatim të Urdhrit nr. 341, datë 17.09.2019, “Për ngritjen e grupit të punës për ndarjen e OSHEE sh.a.”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është në pritje të ndryshimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që të vijohet me finalizimin e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. dhe që operatorët e krijuar të jenë plotësisht operativë në datën 01.01.2020.
- Duke qënë se nga ana e OSHEE sh.a. dhe MIE janë marrë masat e nevojshme për lehtësimin dhe përfundimin e procesit të ndarjes efektive të OSHEE, përpara janarit 2020.
- Duke marrë në konsideratë që periudha tranzitore, miratuar me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, të bordit të ERE, përfundon në datën 21.12.2019.
- Bordi I ERE me vendimin nr. 164, Datë 04.11.2019, është shprehur “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë furnizuesi i shërbimit universal sha (FSHU sha) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga data 21.12.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të shoqërisë operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a.); miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal“ sh.a. (FSHU sh.a.) miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 215, datë 11.10.2018.

2. Deri në përfundimin e periudhës tranzitore parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimin të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a.
3. Për efekt të llogaritjes së afateve të shtrirjes së fuqisë juridike të licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sha (FSHU sha) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, ky afat rivendoset sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë OSHEE sh.a. dhe MIE për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**